

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATIVES - DIRECTION DE L'ADMINISTRATION

Ar.faq/Dr.str. 230

Datë/Datum. 07.12.2018

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së XI - të, e rregullt, e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datë 14.11.2018, ora 09:00h, në sallën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës. Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Ilir Hasani, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Miranda Shabani, Sabit Bullatovci, Betim Ahmeti, Sabri Rexhepi, Ali Zogiani, Durim Hajra, Eglantina Azemi, Doruntina Jashari, Aida Alimi, Arjana Zogiani, Naser Graiçevci, Migjen Kolshi, Mehdi Lahu, Shaban Ademi, Driton Ademi, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Qerim Gara, Bashkim Krasniqi dhe Ljubisa Qirkoviq.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkyetar i Komunës, Halil Qerimi - Nënkyetar i Komunës për Komunitete, Abdullah Prebreza - Drejtor i Planifikimit Urban, Ramadan Jashanica - Drejtor i Financave dhe Buxhetit, Ekrem Berjani - Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Jakup Tërnavë - Drejtor i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, Afrim Krasniqi - Drejtor i Inspektoratit, Nuriye Avdiu - Drejtoreshë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Maliq Berisha - Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.

Të tjerë: Përfaqësuesit e OSBE-së, KFOR-it dhe qytetarë.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstrakteve të procesverbalit nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të datës: 26.09.2018, 10.10.2018 dhe 25.10.2018.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Propozim për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2019.
4. Propozim për bartjen e pronave shoqërore në pronësi të Komunës së Fushë-Kosovës.
5. Propozim për caktimin e aksionarëve në Kompaninë Rajonale për menaxhimin e mbeturinave 'Pastrimi'.
6. Shqyrtimi i parë i Propozimit për ndryshim-plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë.
7. Propozim për vazhdimin e projektit të bashkëfinancimit me KARITAS-in për vitin 2019.
8. Propozim për fillimin e procedurave për themelimin e teatrit të qytetit në Fushë-Kosovë.
9. Propozim për ndërrimin e pronës për ndërtimin e shkollës në lagjen e Nakaradës.

10. Propozim për shqyrtimin e kërkesës së Organizatës ‘Terre des Hommes’ për Qendrën Ditore për mbrojtjen e fëmijëve me qëndrim në rrugë dhe shqyrtimi i rekomandimit nga Komiteti për Politikë e Financa që objekti publik - çerdhja, të ridestinohet për Arkiv të Komunës.

11. Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës kërkoi nga anëtarët e Kuvendit të Komunës që të deklarohen për rendin e ditës së propozuar. Hap diskutimin.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të votojnë për aprovimin e rendit të ditës së propozuar.

U votua me: njëzet e pesë vota ‘për’, një ‘kundër’ dhe një abstenim, gjithsej njëzet e shtatë anëtarë. Në bazë të votimit Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi rendin e ditës së propozuar.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të datës: 26.09.2018, 10.10.2018 dhe 25.10.2018.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Tani i kemi për aprovim ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara të Kuvendit të Komunës, të mbajtura më datë: 26.09.2018, 10.10.2018 dhe 25.10.2018, hap diskutimin për vërejtjet apo sugjerimet tuaja.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje është kundër aprovimit të ekstrakteve të procesverbaleve sepse audioincizimet e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës nuk po publikohen.

Aida Alimi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne kërkojmë që të bëhet publikimi i audioincizimeve dhe deri në publikimin e audioincizimeve jemi kundër.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës i qiti në votim për aprovim ‘Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të mbajtura më datë: 26.09.2018, 10.10.2018 dhe 25.10.2018.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota ‘për’, tetë ‘kundër’ dhe një abstenim, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, i aprovoi ‘Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të mbajtura më datë: 26.09.2018, 10.10.2018 dhe 25.10.2018.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën ‘Pyetje dhe përgjigje parlamentare’, ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës që të parashtrojnë ndonjë pyetje nëse kanë për Ekzekutivin e Komunës.

Migjen Kolshi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtorinë e Arsimit dhe Drejtorinë e Inspektoratit, kërkoj që të ndërmerren masa sepse në oborrin e shkollës 'Selman Riza' dhe 'Hivzi Sulejmani' nxënësve po u shiten cigare me copë për 20 cent, kështu ata mund t'i blejnë më lehtë, andaj unë kërkoj që të ndërmerren masa parandaluese! E dyta, kërkoj sqarime në lidhje me donacionin që Komuna e Fushë-Kosovës i ka dhënë Komunës së Suharekës ku Kryetari i Komunës së Suharekës ka deklaruar se ky investim për ndërtimin e shtëpisë është me çelësa në dorë, atje janë parë zyrtarja e kadastrit, zyrtari i shërbimeve publike dhe një zyrtar i mirëqenies sociale, ne kërkojmë ta dimë se cila është lidhja me atë familje atje! Unë kam qenë atje për të marrë sqarime dhe më është thënë se 'kjo punë është konfidenciale'! Ne të gjithë e dimë që zyrtarja e kadastrit është me origjinë nga Komuna e Suharekës. Në raportin e gjashtëmujorit të Zyrës së Prokurimit e kemi një shpenzim prej 40 mijë eurove për dezinfektimin e ajrit, pyes a ka ndodhë kjo, meqë tani jemi në muajin e njëmbëdhjetë, dhe kjo punë në fshatrat tona gjatë periudhës së verës nuk është kryer asnjëherë?! Po ashtu kërkesë tjetër është që të bëhet pastrimi i rrugëve të Fushë-Kosovës. Nga Drejtoria e Kulturës kërkoj informata për shpenzimet që bënë Ansambli 'Zëri i Kosovës' për periudhën njëvjeçare? Këtë pyetje e kam parashtruar edhe në mbledhjet e kaluara por nuk kam marrë përgjigje?

Shaban Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Pyes Nënkryetarin e Komunës, a jeni Nënkryetar i Komunës apo Drejtor i Inspektoratit?

Nënkryetari i Komunës: Përderisa jam këtu jam nënkryetar dhe kërkoj nga ju që të mos merreni me fjalë sepse çdo ndryshim përcillet me Vendime.

Shaban Ademi: Sa për informacion, çështjen e ngritur nga anëtari i Kuvendit, z. Migjen Kolshi, lidhur me subvencionet, unë e kam ngritur në mbledhjet e kaluara. Tani e kam një pyetje për Drejtorin e Inspektoratit, në rrugën tuaj, një objekt që është në ndërtim e sipër a ka leje ndërtimore? Pastaj në rrugën 'Majaci', objekti që po ndërtohet a ka leje ndërtimore? Nënkryetarin e Komunës e pyes, cili është plani i Ekzekutivit për legalizimin e ndërtimeve pa leje, apo do të veproni sikur në të kaluarën, njëherë ndërtohet objekti pastaj merren vendimet për legalizimin e tyre?

Nënkryetari i Komunës: Trajtimi i ndërtimeve pa leje bëhet në bazë të dispozitave të 'Ligjit për legalizim' që do të miratohet nga Kuvendi i Kosovës.

Shaban Ademi: Pyes, pse lejoni ndërtimin e objekteve pa leje të cilat theksoni se do të legalizohen? Për këtë çështje dhe katrohurën në ndërtim dikush do të shkojë në burg, por nuk dihet sa persona!

Nënkryetari i Komunës: Shumica e ndërtimeve janë me leje ndërtimore, ndërsa të gjitha objektet e ndërtuara pa leje ne do t'i trajtojmë sipas 'Ligjit për legalizim', se a i plotësojnë kushtet për legalizim, ato që nuk i plotësojnë kushtet sipas rregullave duhet të rrënohen. Ju nuk duhet të merreni me atë se a shkon dikush në burg apo jo, sepse secili nga ne punën e tij e bën në bazë të ligjit dhe detyrave të punës, nuk është e nevojshme që të flitet pa argumente.

Shaban Ademi: Objektet ndërtimore ngritën, këtu janë përfitimet e juaja, dhe kësaj pune fund e krye i thuhet mafiozitet! Kryeinspektorit komunal në rrugën e vet i bëhen ndërtime pa leje, për të gjitha këto çështje unë jam duke i bërë dosjet që duhet të shqyrtohen nga gjykatat. E kam një pyetje për Drejtorin e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, a ka të paktën një rast që është kryer bartja e pronës pa transaksion bankar?

Drejtori i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Nuk ka. Të gjitha lëndët shqyrtohen dhe barten në bazë të ligjit që e rregullon bartjen e pronësisë.

Aida Alimi: Unë kërkoj që të marr një përgjigje me shkrim lidhur me kërkesën tonë për ndryshimin e emërimit të rrugës 'Dardania' në Fushë-Kosovë.

Mehdi Lahu: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit që ta kemi një informatë se a ka mundësi që Njësia e Zjarrfikësve të vendoset në Fushë-Kosovë, sepse para disa ditësh, me rastin e shpërthimit të një zjarri në rrugën 'Nënë Tereza', afër Bankës Raiffeissen, intervenimi është vonuar për një orë, kurse në fshatrat e largëta, si Bardh i Madh dhe Harilaç, supozohet se vonesat do të ishin edhe më të mëdha dhe zjarri do ta bënte të veten? Në Prishtinë puna e zjarrfikësve ka filluar të rregullohet edhe nëpër lagje. Pyetja tjetër ka të bëjë me kyçje në rrjetin e ujësjellësit, a do të realizohet ky projekt brenda këtij viti për qytetarët e Fushë-Kosovës? Për Drejtorinë e Arsimit e kam një pyetje dhe shqetësim për nxënësit në fshatin Miradi e Poshtme, ku nxënësit e ciklit të ulët nga klasa e parë deri në të pestën nuk lejohet të hyjnë në oborrin e shkollës deri në orën 12:50 minuta, edhe pse në oborrin e kësaj shkolle ka hapësirë të mjaftueshme, ku një pjesë e oborrit të shkollës është e betonuar dhe nxënësit mund të qëndrojnë aty e mës të mbesin jashtë oborrit të shkollës me këmbë të lagura - kjo është e pakuptimtë! Thuhet se kjo është një shkollë e mirë, mirëpo shkolla e mirë pa nxënës nuk na duhet!

Driton Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë deri tani i kam bërë më shumë se pesëmbëdhjetë pyetje dhe nuk kam marrë asnjë përgjigje! Kjo punë po tentohet të bëhet si normale! Ne në asamble bëjmë pyetje dhe nuk marrim përgjigje! Këtu është ndikimi i Kryetarit dhe Ekzekutivit të Komunës edhe të Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës edhe sa i përket procesverbalit dhe pyetjeve, andaj unë do ta bojkotoj këtë pikë sepse nuk kam nevojë që të bëjë pyetje për të cilat nuk kthehen përgjigje, kjo është e drejtë e imja. Kërkoj nga opozita që ta krijojmë një strategji për t'iu përgjigjur arrogancës së numrave në Kuvendin tonë.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit lidhur me deponitë e shumta në komunën tonë të cilat po ndotin edhe shtretërit e lumenjve! Pse në komunën tonë nuk ka pasur asnjë aktivitet në kuadër të aksionit 'Ta pastrojmë Kosovën'? Në hyrje të fshatit Miradi e Epërme nën urë në relacionin Prishtinë / Pejë është një deponi, por ka edhe shumë të tjera në territorin e komunës sonë. Për Drejtorinë e Planifikimit Urban, rruga 'Hajrullah Zymi' nuk është asfaltuar në mënyrë cilësore, po ashtu shiriti ndihmës nga rrethi deri tek 'Interexi' nuk është punuar si duhet, aty janë mbuluar pusët dhe në disa vende ka gropa të thella! Pyes, objekti i vjetër i shkollës në fshatin Bardh i Madh shfrytëzohet nga një biznes privat, ne duam ta dimë a është marrë vendim për ridestinimin e këtij objekti dhe cila është veprimtaria biznesore që zhvillohet aty, apo kemi të bëjmë me uzurpim të hapësirave publike aty?! Në fund kërkojmë që për pyetjet tona përgjigjet t'i marrim me shkrim.

Eglantina Azemi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në bazë të nenit 52.1 Kuvendi ka themeluar Komitete tjera këshillëdhënëse të cilat i kanë disa kompetenca edhe në bazë të Statutit të Komunës dhe Rregullores për punën e Komiteteve tjera, mirëpo ato nuk janë ende funksionale! Pyes, cila është arsyeja, mungesa e materialit për shqyrtim apo ndonjë arsye tjetër?

Driton Hasolli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kërkesa jonë e dorëzuar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për ndërtimin e impiantit për ujëra të zeza në lumin 'Drenicë' nuk është përkrahur sepse kjo nuk është prioritet sipas tyre, mirëpo për vitin 2019 është ndarë një projekt në shumë prej 150 mijë eurosh dhe vitin 2020 në shumë prej 100 mijë eurosh për rregullimin e shtratit të lumit 'Drenicë'. Në rrugën 'Fazli Graiçevci' në Fushë-Kosovë janë të vendosur 5 kontejnerë, mirëpo kjo nuk është në proporcion me numrin e banorëve, andaj kërkojmë

që të shtohet numri i tyre, si dhe të intervenohet në rregullimin e ndriçimit publik aty. Ne kërkojmë nga Ministria e Transportit që në fshatin Miradi e Poshtme urgjentisht të vendoset një mbikalim sepse në atë zonë njerëzit janë shumë të rrezikuar, aty ka pasur edhe viktima.

Eglantina Azemi: Pyes Drejtorin e Arsimit cilat janë kriteret për ndarjen e bursave për studentë?

Nënkryetari i Komunës: Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës janë dhënë përgjigje nga drejtoritë përkatëse ndërsa unë ju sugjeroj që nëse nuk ka përgjigje të drejtpërdrejta ato të jepen në mbledhjen e ardhshme.

Drejtori i Inspektoratit: Përshtendes të pranishmit në mbledhje. Edhe sipas Udhëzimit Administrativ nuk lejohet shitja e duhanit për personat nën moshën 18 vjeçare. Unë jam njoftuar për këtë problem dhe inspektorët kanë dalë në terren për ta eliminuar këtë dukuri. Në rrugën 'Nënë Tereza' objekti që po ndërtohet prona është e Ahmet Gjyrevcit, nuk ka leje ndërtimore, por ka kushte urbanistike, ditën e shtunë është vendosur beton aty, inspektorët e ndërtimit kanë dalë në terren i kanë ndërprerë punimet dhe i kanë vendosur shiritat. Në rrugën 'Vëllezërit Majaci', aty ndërton Kompania 'Canolli', ka leje ndërtimore dhe punimet vazhdojnë.

Shaban Ademi: Këto arsyetime tuaja dhe të Nënkryetarit të Komunës janë arsyetime boshe dhe vazhdojnë për 20 vite, fillohen ndërtimet me kushte, objektet ndërtohen, vendosen shiritat, dërgohen lëndët në gjykatë, mirëpo pronarët e tyre i shesin banesat, asnjë objekt nuk rrënohet. Në Fushë-Kosovë ka më tepër se 120 raste të ndërtimit për të cilat nuk është ndërmarrë asnjë veprim ligjor. Kjo punë bëhet me vullnet sepse nuk duhet të prishen planet e Ekzekutivit, ndërtimet janë enorme dhe një pjesë e madhe e tyre janë të paligjshme.

Drejtori i Inspektoratit: Institucionet e shtetit funksionojnë, qeveria, gjykatat, nëse keni dokumentacion mund t'i drejtoheni organeve gjegjëse. Nuk duhet të fyeri, e jotja është t'i vazhdoni procedurat.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit: Përshtendes të pranishmit në mbledhje. Lidhur me pyetjen e anëtarit të Kuvendit të Komunës, z. Mehdi Lahu, për Njësinë e Zjarrfikësve dhe pozicionin e tyre në kuadër të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, apo të komunave, kjo çështje nuk është zgjidhur ende. Ne i kemi katër zjarrfikës dhe kemi telashe për ta përmirësuar njësinë, në fshatin Pomozotin e kemi ndarë një ngastër kadastrale, mirëpo Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave nuk e ka pranuar. Është e vërtetë se ndonjëherë kemi vonesa dhe telashe mirëpo këto janë mundësitë që i kemi në dispozicion. Mbeturinat në fshatin Kuzmin i kemi pastruar disa herë, kemi bërë edhe gardhimin e varrezave mirëpo mbeturinat hidhen vend e pa vend. Sa i përket ndriçimit, në fillim kjo punë është kontestuar derisa është kuptuar se kjo është e nevojshme është provuar me ndriçim solar dhe më vonë është kthyer me furnizim me rrymë nga KEDS-i. Ne do të intervenojmë duke u mbështetur në mundësitë buxhetore. Rruga 'Dardania' dhe rruga 'Nënë Tereza' do të trajtohen vitin e ardhshëm. Sa i përket furnizimit me ujë në qytetin e Fushë-Kosovës tenderi tani është hapur nga Kompania Rajonale e Ujësjetillësit 'Prishtina'. Lidhur me emërtimin e rrugëve do të formohet një komision i ri i cili do t'i shqyrtojë kërkesat për ndryshimin e emërtimeve. Ndërsa pastrimin në lagjen e 'Graiçeveve' do ta bëjmë shumë shpejt.

Drejtori i Arsimit: Përshtendes të pranishmit në mbledhje. Unë sot jam informuar për shitjen e cigareve nxënësve me copë në oborrin e shkollës 'Selman Riza' dhe më këtë çështje do të merrem shumë seriozisht duke angazhuar stafin e shkollës dhe policinë. Sa i përket shkollës 'Vëllezërit Frashëri' në fshatin Miradi e Poshtme kjo shkollë është ndër shkollat më të mira. Gëlqerosja e fundit është bërë para pesë viteve dhe nxënësit hyjnë në oborrin e shkollës kur moti është me shi,

mirëpo këtu ka tendencë që të atakohet puna e mirë e drejtorit të shkollës. Megjithatë, unë do të bisedoj me të dhe do ta gjejme një zgjidhje të pranueshme për të gjithë. Objekti i vjetër i shkollës në fshatin Bardh i Madh nuk ka nevojë të rinovohet sepse është i dëmtuar shumë dhe ju të gjithë e dini se shkolla e mesme në fshatra tani më nuk praktikohet. Kriteret për ndihmë studentëve janë të publikuara në ueb-faqen zyrtare, studenti duhet ta ketë notën mesatare 8, të mos ketë ndërprerje gjatë studimeve. Përparësi u kemi dhënë studentëve të fakulteteve të edukimit, mjekësisë dhe teknikut, në këtë vit janë ndihmuar rreth 120 studentë.

Mehdi Lahu: Të thuhet se drejtori i shkollës po e mirëmban mirë shkollën nuk është e arsyeshme, sepse shkolla është për nxënës! Madje në oborrin e kësaj shkolle është një hapësirë e gjerë e betonuar.

Sabit Bullatovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Këto vërejtje po i bënë dikush që nuk i ka fëmijët në këtë shkollë, sepse prindërit janë të kënaqur me ruajtjen e shkollës dhe nivelin e disiplinës. Problemi është edhe te disa nëna të cilat vinë gjysmë ore para kohe dhe krijojnë aty tollovi të panevojshme.

Drejtoresha e Kulturës, Rinisë dhe Sportit: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ansambli 'Zëri i Kosovës' subvencionohet nga Komuna dhe çdo herë e dorëzon raportin financiar për shpenzimet, as auditori i brendshëm e as ai i jashtëm nuk kanë dhënë ndonjë vërejtje për financimin e kësaj organizate joqeveritare nga buxheti i komunës.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani po kalojnë pesë vite dhe audioincizimet e mbledhjeve nuk publikohen, përgjigjet në shumicën e pyetjeve nuk kthehen dhe kjo po paraqet një rol dyfytirësh sa i përket trajtimit të këtyre dy çështjeve. Unë nuk dua këtu ta luaj rolin e hipokritit por shkolla në fshatin Miradi e Epërme është e demoluar dhe ky drejtor nuk e trajton si duhet këtë shkollë që e ka në menaxhim. Ne jemi organi më i lartë i komunës andaj kërkojmë që çështjet e ngritura nga ne të trajtohen në mënyrë serioze dhe të dinjitetshme.

Sabri Rexhepi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Pyes, në rrugën 'Vëllezërit Majaci' a është i rregulluar parkingu sipas standardeve të ndërtimit? Po ashtu duke filluar nga stacioni i trenit parkingu është i zënë. Pyes, a është legalizuar ndërtesa te udhëkryqi? Ne nuk duhet të bëjmë spektakël siç ka bërë ish/kryetari Skënder Zogaj duke rrënuar një objekt shumë të vogël dhe gjatë rrënimit të tij ka deklaruar se do t'i rrënojmë edhe objektet e tjera pa leje. Në lagjen 'Dardania' tek banesat e 'Pozhegu 2' janë gjithsej 230 banesa dhe 30 lokale, ka mungesë të kontejnerëve, gjendje e njëjtë është edhe në rrugën '17 Shkurti', kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit që të merr masa për ndryshimin e gjendjes në këtë pjesë të qytetit.

Pika e tretë (3) - Propozim për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2019.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për formimin e Grupit Punues për Hartimin e planit vjetor të punës së Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2019'. Ne propozojmë që ky Grup Punues të jetë gjithëpërfshirës, me përfaqësues të subjekteve politike të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës. Hap diskutimin.

Ali Ismaili: Vendimi për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa është i paligjshëm. Unë kërkoj që renditja e subjekteve politike të bëhet sipas rezultateve të Komisionit Qendror Zgjedhor duke filluar nga Nisma, AAK, PD dhe pastaj AKR-ja, e jo të përdoren standarde sipas marrëveshjeve me njerëz servil që ju përkrahin - si përfaqësuesi i AKR-së!

Driton Hasolli: Të nderuar kolegë asamblist, është banale të thuhet se unë e kam pranuar këtë pozitë dhe jam servil, servil jeni ju përfaqësuesi i Partisë së Drejtësisë, sepse unë kam vendosur të

pranoj të jem anëtar i Komitetit për Politikë e Financa pasi që ju nuk keni pranuar që të zhbllokoni situatën dhe pengesat që keni vendosur për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Ali Ismaili: Ne po kërkojmë diçka që na mundëson ligji. Ju e keni tradhtuar marrëveshjen e arritur ndërmjet neve si përfaqësues të subjekteve politike, me nga një anëtar në Kuvendin e Komunës. Rast se si duhet të zgjidhet kjo çështje e keni Komunën e Vushtrrisë.

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Për anëtar të Grupit Punues për 'Hartimin e planit vjetor të punës së Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës' ne e propozojmë anëtarin e njëjtë, pra, mua - Remzi Shalën.

Driton Ademi: Ne si parti nuk do të marrim pjesë në hartimin e këtij plani të punës sepse nuk e njohim si të ligjshëm Komitetin për Politikë e Financa.

Durim Hajra: Nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje për anëtare të Grupit Punues për 'Hartimin e planit vjetor të punës së Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2019' e propozojmë znj. Eglantina Azemi.

Ariana Zogiani: Nga Partia Demokratike e Kosovës për anëtare të Grupit Punues për 'Hartimin e planit vjetor të punës së Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2019' e propozojmë znj. Aida Alimi.

Naser Graiçevci: Për anëtar të Grupit Punues për 'Hartimin e planit vjetor të punës së Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2019' e propozojmë z. Migjen Kolshi.

Shaban Ademi: Ne nuk do të marrim pjesë në punën e Grupit Punues.

Bashkim Krasniqi: Nga radhët e komuniteteve, me pajtimin e kolegëve, anëtar i Grupit Punues do të jem unë.

Nënkryetari i Komunës: Nga radhët e Ekzekutivit të Komunës për anëtare të Grupit Punues për 'Hartimin e planit vjetor të punës së Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2019' e propozojmë znj. Nuriye Fazliu – Drejtore e Administratës.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2019'.

U votua me: njëzet e katër vota 'për' një 'kundër' dhe dy abstënim, gjithsej njëzet e shtatë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2019' dhe mori:

V E N D I M

1. Për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2019, në përbërje prej nëntë (9) anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, kryetare i grupit;
 - 1.2 Nuriye Fazliu - Drejtore e Administratës;
 - 1.3 Hasan Gjyrevci - Zyrtar Ligjor për Kuvend dhe Komitete, anëtar;
 - 1.4 Remzi Shala - Përfaqësues i LDK-së, anëtar;
 - 1.5 Eglantina Azemi - Përfaqësuese e LVV-së, anëtare;
 - 1.6 Aida Alimi - Përfaqësuese e PDK-së, anëtare;
 - 1.7 Driton Hasolli - Përfaqësues i AKR-së, anëtar;
 - 1.8 Migjen Kolshi - Përfaqësues i Iniciativës Qytetare të Fushë-Kosovës, anëtar;
 - 1.9 Bashkim Krasniqi - Përfaqësues i Partisë Liberale Egjiptiane, anëtar.

Pika e katërt (4) - Propozim për bartjen e pronave shoqërore në pronësi të Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin e Ekzekutivit të Komunës për bartjen e dy pronave shoqërore në lokacionin te stadiumi 'Ekrem Graiçevci' për nevojat e zhvillimit të sportit në pronësi të komunës'. Ftoj Drejtorin e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës që të na jap sqarime.

Drejtori i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Këtu kemi të bëjmë me dy prona që ndodhen në lokacionin te stadiumi, ku për njërën pronë e kemi pjesën tekstuale, mirëpo mungon ndarja grafike sepse librat kadastral gjenden në Serbi.

Doruntina Jashari: Sipërfaqja e ngastrës së parë kadastrale 776-1 gjendet në gjeoportale, ndërsa ngastra e dytë, në sipërfaqe prej 5430 m², nuk gjendet në gjeoportale dhe kur mblidhen këto dy parcela sipërfaqja nuk përputhet për 473 m². Ne jemi për bartjen e këtyre pronave por me sipërfaqe të sakta.

Migjen Kolshi: Ne kërkojmë të kemi sqarime se a përfshihet në këtë pjesë rruga që është aty dhe sipërfaqja e ndarë nga qeverisja e mëhershme për Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!

Sabit Bullatovci: Në këto dy ngastra kadastrale përfshihet komplet fusha e futbollit, sipërfaqja është e njëjtë prej 24 000 m², mirëpo ne nuk e kemi grafikën për ngastrën e dytë sepse ato libra të ndarjeve gjeodezike dhe fizike në terren nuk na janë kthyer ende.

Durim Hajra: Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje është 'për' - në parim, mirëpo kërkojmë sqarime për diferencën ndërmjet këtyre dy pronave.

Ali Ismaili: Meqë pikat e rendit të ditës nuk po përgatiten si duhet ne kemi dyshime sepse nuk po kemi informata. Pajtohemi me atë që e sqaroi anëtari i Kuvendit të Komunës, z. Sabit Bullatovci, mirëpo ne nuk po i kemi këto informata!

Migjen Kolshi: Pyes, a hyn pjesa tjetër e sipërfaqes aty që tani për tani është e uzurpuar?

Sabit Bullatovci: Këto prona kanë të bëjnë vetëm me stadiumin, për të cilin e sqarova se nuk i kemi shënimet grafike. Pjesa tjetër është në shfrytëzim nga KEK-u.

Nënkryetari i Komunës: Ne këtu po e kërkojmë një pronë që nuk është e jona. Në mandatin e kaluar Kuvendi e ka ndarë aty një hapësirë për nevojat e trafostacionit për tensionin e lartë.

Durim Hajra: Pyes Nënkryetarin e Komunës, ku gjendet prona e dytë?

Jetmir Berisha: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani ne i morëm sqarimet e nevojshme nga anëtari i Kuvendit, z. Sabit Bullatovci dhe kërkojmë që ky propozim të përkrahet sepse është në të mirë të zhvillimit të sportit, askush nuk investon në një klub ku nuk është i rregulluar statuti pronësor i tij.

Driton Ademi: Nisma Socialdemokrate pajtohet me propozimin që pronat shoqërore të barten në pronësi të komunës.

Naser Graiçevci: Shqetësimet e anëtarëve të Kuvendit janë të arsyeshme, sepse duhet të përmirësohet qeverisja lokale, ta kemi një plan për pronat komunale, e jo të merremi me to në mënyrë ad-hoc. Neve nga Drejtoria e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës nuk na është dorëzuar lista e pronave, andaj ka devijime të tilla edhe në opinion për shkak të qasjes joparimore të Ekzekutivit të Komunës.

Nënkryetari i Komunës: Bartja e këtyre pronave në pronësi të komunës është deklaruar se do të bëhet nga Kryeministri i Kosovës, z. Ramush Haradinaj. Ne kemi synuar që të mos merremi me ngastra kadastrale të vogla sepse hapësirat për shkolla dhe qendra të mjekësisë familjare duhet të jenë më të mëdha se pesë ari.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin e Ekzekutivit të Komunës për bartjen e dy pronave shoqërore në lokacionin te stadiumi 'Ekrem Graiçevci' për nevojat e zhvillimit të sportit në pronësi të komunës'.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për' asnjë 'kundër' dhe pesë abstenime, gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin e Ekzekutivit të Komunës për bartjen e dy pronave shoqërore në lokacionin te stadiumi 'Ekrem Graiçevci' për nevojat e zhvillimit të sportit në pronësi të komunës' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e 'Propozimit Nr. 1575, të datës 31.10.2018 për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për bartjen e pronësisë së Ngastrave Kadastrale nga prona shoqërore në pronësi të Komunës së Fushë-Kosovës', si vijon:
 - 1.1 Ngastra Kadastrale Nr. 00776-1, në sipërfaqe prej 19248m², në pronësi të P.sh. Kosova Eksport - N.sh. Bujqësia, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë;
 - 1.2 Ngastra Kadastrale Nr. 00776-2, në sipërfaqe prej 5430m², në pronësi të P.sh. Kosova Eksport - N.sh. Bujqësia, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë.
2. Bartja e Ngastrave Kadastrale, të cekura në pikën 1.1 dhe në pikën 1.2 sipas vendimit në pronësi të komunës, i mundësojnë Komunës së Fushë-Kosovës ofrimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm publik për zhvillimin e infrastrukturës së sportit në Stadiumin e Futbollit 'Ekrem Graiçevci' në Fushë-Kosovë.

Pika e pestë (5) - Propozim për caktimin e aksionarëve në Kompaninë Rajonale për menaxhimin e mbeturinave 'Pastrimi'.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për caktimin e dy anëtarëve të Kuvendit të Komunës për Komisionin e Aksionarëve në Kompaninë Rajonale për Menaxhimin e Mbeturinave - Pastrimi', ftoj subjektet politike që të japin propozimet e tyre.

Remzi Shala: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës për aksionar në Kompaninë Rajonale për Menaxhimin e Mbeturinave 'Pastrimi' e propozojmë z. Ilir Hasani, ekonomist i diplomuar.

Doruntina Jashari: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për aksionar në Kompaninë Rajonale për Menaxhimin e Mbeturinave 'Pastrimi' e propozojmë z. Durim Hajra, ekonomist i diplomuar.

Nënkryetari i Komunës: Nga Ekzekutivi i Komunës për aksionar në Kompaninë Rajonale për Menaxhimin e Mbeturinave 'Pastrimi' e propozojmë z. Ekrem Berjani, ekonomist i diplomuar.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për caktimin e anëtarëve: Ilir Hasani, Durim Hajra dhe Ekrem Berjani për Komisionin e Aksionarëve në Kompaninë Rajonale për Menaxhimin e Mbeturinave - Pastrimi'.

U votua me: njëzet vota 'për' asnjë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej njëzet e një anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për caktimin e anëtarëve: Ilir Hasani, Durim Hajra dhe Ekrem Berjani për Komisionin e Aksionarëve në Kompaninë Rajonale për Menaxhimin e Mbeturinave - Pastrimi' dhe mori:

V E N D I M

1. Për caktimin e anëtarëve në Komisionin Komunal të Aksionarëve në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave 'Pastrimi' për periudhën e ardhshme trevjeçare si vijon:
 - 1.1 Ilir Hasani - përfaqësues i LDK-së, ekonomist i diplomuar, anëtar;
 - 1.2 Durim Hajra - përfaqësues i Lëvizjes Vetëvendosje, ekonomist i diplomuar, anëtar;
 - 1.3 Ekrem Berjani - përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës, master i financave dhe kontabilitetit ndërkombëtare, anëtar.

Pika e gjashtë (6) - Shqyrtimi i parë i Propozimit për ndryshim-plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi në shqyrtimin e parë 'Propozimin për ndryshimin - plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare Dr. Fatmir Krasniqi në Fushë-Kosovë'. Hap diskutimin.

Remzi Shala: Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më datë 22.08.2018, ka propozuar që të bëhet ndryshimi i nenit 9 të Statutit dhe në kuadër të tij të hyj 'Shërbimi konsultativ për gjinekologji dhe pediatri'. Ju e dini se këtë Statut e ka miratuar Kuvendi i Komunës si Statut unik.

Eglantina Azemi: Përveç ndryshimeve të propozuara ne kërkojmë që në këto ndryshime të përfshihet edhe mamografi që është jetik për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve.

Aida Alimi: Në ndryshimin e Statutit propozoj që të hyj edhe 'Shërbimi i këshillimit për nënat e reja'.

Driton Ademi: Në parim ne e përkrahim çdo ndryshim që është në kompetencë të shëndetësisë parësore, mirëpo ne mendojmë se këtu nuk kemi të bëjmë me një lëshim të vogël, duke mos e përfshirë 'Shërbimin e gjinekologjisë dhe pediatri', por me kopjimin e akteve normative.

Mirvete Gërguri: Pajtohem që të bëhen këto ndryshime në Statut, mirëpo kërkojmë që orari i punës të jetë më i gjatë nëpër fshatra dhe të respektohet parimi që shërbimet shëndetësore të jenë më afër qytetarëve.

Remzi Shala: Në mandatin e kaluar vërejtjet kanë qenë që nëse nuk e miratojmë një Statut unik ai do të kthehet në rishqyrtim nga Ministria e Shëndetësisë.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim në parim për diskutim publik të 'Propozimit për ndryshimin - plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare Dr. Fatmir Krasniqi në Fushë-Kosovë'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e një anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi në parim për diskutim publik 'Propozimin për ndryshimin - plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare Dr. Fatmir Krasniqi në Fushë-Kosovë' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim të Propozimit Nr. 915, të datës 22.10.2018 për ndryshim-plotësimin e nenit 9, të Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë Nr. 140, të datës 29.09.2017, me plotësimin për sektorin konsultativ lidhur me shërbimet për pediatriinë dhe gjinekologjinë, si dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik.

Pika e shtatë (7) - Propozim për vazhdimin e 'Projektit të bashkëfinancimit me KARITAS-in për vitin 2019'.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për vazhdimin e projektit të bashkëfinancimit me KARITAS-in për vitin 2019', ku janë të punësuar njëqind e pesë punëtorë, listën e punëtorëve e keni të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës. Hap diskutimin.

Durim Hajra: Komuna e Fushë-Kosovës për disa vite radhazi e vazhdon 'Projektin e punësimit me bashkëfinancim me KARITAS-in', në mënyrë të gabuar dhe skandaloze mbështet KARITAS-in dhe kjo punë paraqet një kundërthënie me kërkesën, por tani i kemi dy të reja - paraqiten kodet buxhetore të financimit dhe lista e të angazhuarve! Tani ky projekt i punësimit po rritet në shumën e mjeteve financiare prej 395,000.00€, ku 375,000.00€ jepen nga buxheti i komunës, ndërsa vetëm 20,000.00€ nga Organizata Joqeveritare KARITAS. Sipas kësaj logjike 95% e financimit është nga buxheti i komunës, ndërsa bartës i projektit është KARITAS-i, kjo është një kundërthënie! Ky punësim realizohet për punësimin e militantëve partiakë, në shëndetësi dhe fusha tjera, projekti e mban titullin 'Shërbimet e përkujdesit social dhe shëndetësor', e jo militantët e subjektit politik! Nga njëqind e pesë punëtorët, stomatolog ka shumë pak, ka shumë punëtorë të sigurimit, shoferë, punëtorë të angazhuar për shërbime publike! Në listën e punëtorëve janë të përshkruar emrat e tyre, mungon raporti për pagat dhe profesionin e tyre, këtu nuk kemi të bëjmë me ekspertë të fushave përkatëse, por me punëtorë të shërbimeve teknike! Nuk e kemi një raport për vijueshmërinë e punëtorëve në punë! Auditivi i Jashtëm lidhur me këtë çështje e ka dhënë të gjeturën - rekomandimin e tetë, po e lexoj projekti 'home care', nuk ka qenë i planifikuar me buxhet, ndërsa për këtë projekt nga buxheti i komunës është ndarë shuma e mjeteve financiare prej 222,000.00€ apo 93% e projektit për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, aty theksohet se vetëm 32 punëtorë punojnë në shëndetësi dhe 60 të tjerë në administratë. Transferimi i mjeteve financiare nga buxheti i komunës te organizata joqeveritare rrezikon objektivat e caktuara me këtë program të punësimit! Shqetësim tjetër i yni është se këtu kemi të bëjmë me një punësim të përkohshëm dhe jo afatgjatë, punëtorët nuk kanë siguri në punë! Ne kërkojmë që të bëhet një zgjidhje afatgjate për punëtorët në arsim dhe shëndetësi, me këtë mënyrë nuk zgjidhet asgjë, andaj Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje është kundër aprovimit të këtij projekti të punësimit!

Mehdi Lahu: Për financimin e 'Projektit të punësimit me KARITAS-in' nga buxheti i komunës për katër vite janë ndarë një milion euro, ne asnjëherë nuk e kemi marrë një planifikim të mirëfilltë dhe të detajuar për planin dhe rezultatet e punës! Për trajtimin e nxënësve me nevoja të veçanta në arsim, trajtimin e personave të vetmuar në shëndetësi, tani propozohet t'i ndajmë mjetet financiare në shumë prej 375,000.00€, apo 150,000.00€ më shumë për njëqind e pesë punëtorë! Nuk dimë cilat janë kriteret për punësimin e tyre, cilat janë pagat e tyre, nga ne kërkohet që ta ngremë dorën për aprovimin e tij, për të cilën mendojmë se kjo nuk është zgjidhje! Në këtë mënyrë nuk zgjidhen problemet në shëndetësi dhe arsim, ne duhet të kërkojmë regjistrimin e popullsisë, këto janë zgjidhje të mesme dhe të paqëndrueshme, andaj kjo kërkesë duhet të refuzohet.

Driton Ademi: Çështja e bashkëfinancimit nuk është e drejtë. Në Kabinetin e Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Reçica, ku unë punoj, kemi analizuar këtë çështje se si do të veprohet me licencimin e këtyre punëve të organizatave joqeveritare dhe punës së tyre sipas Rregullores Nr.

04/2017 dhe si Ministri do ta bëjmë një inspektim të punës së deritashme lidhur me çështjet sociale dhe të familjes edhe në Komunën e Fushë-Kosovës. Pyes, a është marrë me këtë çështje gjatë vitit 2018 Auditori i Brendshëm? Ne tani në tavolinë e kemi një Marrëveshje të Bashkëfinancimit e cila duhet të ndërpritet.

Aida Alimi: Unë nuk dua ta përsëris në fjalimin tim mendimin e njëjtë çdo herë. Nga komuna jonë nuk janë përdorur mekanizmat për regjistrimin e popullsisë, po të ishte bërë kjo punë me kohë ne tani nuk do të kishim nevojë për të gjithë këta punëtorë me projektin e KARITAS-it, ku ka diskriminim edhe në paga! Në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa unë kam kërkuar që të rritet numri i inspektorëve dhe juristëve në këtë projekt të punësimit.

Ali Ismaili: Unë dua të jem i shkurtër në diskutimin tim sepse për këtë çështje kam folur mjaft në vitet e kaluara, kjo punë i ka edhe anët e veta pozitive, sepse ndikon në përmirësimin e disa shërbimeve. Tani shuma e mjeteve financiare për këtë projekt të punësimit po rritet nga 200,000.00€, në 400,000.00€! Në fillim kam kërkuar që të fuqizohen kapacitetet humane në Drejtorinë e Shëndetësisë, të forcohet institucioni e jo të ndahen mjete financiare për organizata joqeveritare! Në arsim i kemi dymbëdhjetë mësuesë pa paga, atje ka nevojë për mësues të kimisë, fizikës, informatikës si dhe lëndëve tjera! Pastaj, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare ka nevojë për mjekë të rinj. Unë nuk jam kundër KARITAS-it por kam kërkuar çdo herë që të kemi raport për shpenzimet dhe veprimtarinë e punës që realizohet - pas katër viteve e kemi një listë të punëtorëve! Raporte të njëjta për shpenzimet kam kërkuar edhe për organizatat tjera joqeveritare, që janë përkrahur nga buxheti i komunës, përkundrazi me njerëzit e kësaj organizate unë njihem, është tentuar që diskutimet e mia t'i ndërlidhin në aspektin fetar, për shkak të pozitës time si Imam, por kjo është e paqëndrueshme, diskutimet e mia kanë qenë parimore. Ne nuk e dimë as tani sa njerëz të sëmurë trajtohen nga ky projekt, sepse nuk kemi asnjë raport të punës! Është thënë nga Dr. Remi se punëtorët e KARITAS-it në shëndetësi kryejnë shumë punë aty, këtu kemi të bëjmë me pagat e njëqind familjeve, ku pagat e këtyre mjekëve dhe mësuesve nuk janë të barabarta me punëtorët tjerë! Mendoj se punëtorëve nuk duhet t'iu japim shpresa të rrejshme, se çështja e punësimit të tyre do të zgjidhet! Nuk është keq të bashkëpunohet me një organizatë joqeveritare, por duhet të mendohet për ngritjen e kapaciteteve shtetërore.

Remzi Shala: Lidhur me vazhdimin e 'Projektit të punësimit me KARITAS-in' unë personalisht jam 'për', për shumë arsye, bartës i projektit është shëndetësia, ku mjekët ofrojnë edhe shërbime shtëpiake, kujdesi paliativ pa ndihmën e tyre nuk mund të funksionojë! Këta punëtorë nuk paguhën si unë, por e bëjnë punën e njëjtë. Unë mendoj se 'Projekti i KARITAS-it për shëndetësi dhe arsim' është i nevojshëm të vazhdohet edhe për vitin 2019, numri i mjekëve dhe infermierëve duhet të rritet. Në shëndetësi të gjithë punëtorët vijojnë punën në mënyrë të rregullt, madje edhe vullneti i tyre për punë është i madh. Unë çdo herë jam që të korrigjohen padrejtësitë nëse ka! Pajtohem që 'Projekti i punësimit në bashkëfinancim me KARITAS-in për vitin 2019' të aprovohet.

Naser Graiçevci: Lidhur me këtë temë pajtohem që përfitues janë disa fusha, por ne e kemi mungesë një 'raport të punës' lidhur me ndikimin e punës së tyre në përf forcimin e shërbimeve në shëndetësi dhe fusha tjera. Disa këtu bëjnë shfajësimet e tyre - si Hoxha, ka pasur mjaft diskutime për këtë projekt, ne kemi thënë fjalën tonë edhe në vitet e kaluara. Unë dua ta di cili është efikasiteti

në punë, në shërbime publike, ku ka një numër të konsiderueshëm të punëtorëve, varrezat janë në gjendje të keqe, të mbuluara me mbeturina, të pa pastruara, ato duhet të mirëmbahen, bizneset i kanë problemet e njëjta, edhe në administratë ka mjaft punëtorë nga ky projekt?! Për këta punëtorë tani ne po e ndajmë shumën e mjeteve financiare prej 375,000.00€ nga buxheti i komunës, ku vetëm 360,000.00€ janë për paga, ndërsa 35,000.00€ përdoren për shërbime administrative dhe të tjera, mendoj se kjo shumë është e paarsyeshme, një pjesë e saj mund të përdoret për punësimin e punëtorëve tjerë në fushat ku nevojat janë më të mëdha!

Shaban Ademi: Për këtë temë u tha mjaft nga parafolësit e mi. Nga buxheti i komunës ne i ndajmë mjetet financiare në shumë prej 375,000.00€, ndërsa KARITAS-i ndan shumën prej 20,000.00€. Është një fakt se kemi rritje të burokracisë nëpër Ministri të ndryshme që nuk merren me problemet e komunave! Duhet të ketë të punësuar në kuadër të këtij projekti në arsim dhe shëndetësi, por jo në administratë! Më herët nga vetë Ekzekutivi i Komunës është theksuar se tridhjetë punëtorë janë tepër në Administratën e Komunës, pse atëherë duhet të merren punëtorë të rinj, këtu janë kritikuar e mia, këtu po manipulohet me votën e tyre?! Nëse hiqen keqpërdorimet nga ky projekt ndikimi i tij në përmirësimin e gjendjes në shëndetësi dhe arsim rritet dhe shihet shumë shpejt.

Nënkryetari i Komunës: Kjo temë është diskutuar në takim edhe me Kryeministrin e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, që ne i kemi çdo tre muaj. Ju duhet ta dini se ky projekt i punësimit është në gjashtëmbëdhjetë Komuna të Kosovës. U cek edhe nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, z. Dritoni, Naseri, e të tjerët, mënyra e funksionimit dhe ndikimi i projektit, unë mendoj se për këtë çështje një qëndrim do ta ketë edhe Qeveria e Kosovës. Secili vendim shqyrtohet nga Ministritë përkatëse, si aspekti përmbajtësor i tij, po ashtu edhe ai financiar, kur kemi të bëjmë me shpenzimin e buxhetit. Ne i jemi përmbajtur sugjerimeve të Auditivit të Jashtëm. Tani shumica e mjeteve financiare për realizimin e këtij projekti të punësimit janë nga kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve. Këtu kemi të bëjmë me interesin direkt të mbi 100 punëtorëve, andaj vendimi është i juaji, vendimi i vitit të kaluar është vlerësuar si vendim i ligjshëm.

Shaban Ademi: Ne jemi të detyruar që banorëve rezident t'ua kryejmë shërbimet, por jo edhe banorëve tjerë! Ka disa mënyra të lejuara për regjistrimin e tyre dhe kryerjen e shërbimeve ndaj tyre, që ju i dini, por ju çdo gjë e lidhni me votë! Struktura juaj nuk është e shtrirë mirë në qytet, andaj ju nuk jeni të interesuar për regjistrimin e popullsisë.

Nënkryetari i Komunës: Në arsim nuk mund ta ndalojmë askënd, arsimi është i obliguar, sepse mjetet financiare për arsim ne i marrim nga buxheti i Kosovës. Ne nuk duhet të ndjekim praktika negative dhe kushtëzime për procesin edukativo-arsimor - si e drejtë elementare për të gjithë.

Ali Ismaili: I nderuari z. Nënkryetar i Komunës përgjegjësia juaj është që ta sillni për shqyrtim dhe analizim raportin e punës, të cilin nuk e kemi pasur për pesë vite. Ne si organ më i lartë i komunës i ndajmë mjetet financiare në shumë prej 400,000.00€, ndërsa nuk merreni me regjistrimin e banorëve rezident dhe punën tuaj! Unë jam për t'ju ndihmuar juve, mirëpo neve po na mungon raporti i punës, andaj e kemi të vështirë se si duhet të veprojmë!

Nënkryetari i Komunës: Unë vetëm e theksova se vendimet tona verifikohen nga organet mbikëqyrëse, që janë Ministritë përkatëse, ne ose e marrim, ose nuk e marrim vendimin për vazhdimin e 'Projektit të punësimit me KARITAS-in për vitin 2019'.

Driton Ademi: Në lidhje me këtë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale do të realizohet një inspektim për t'i hequr dilemat për punën e tyre, ndërsa sa i përket kornizës ligjore të veprimit do të analizohet dhe merret një 'Vendim për zbatimin e Rregullores Nr. 04/2017 për financimin e Organizatave Joqeveritare'.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për vazhdimin e projektit të bashkëfinancimit me KARITAS-in për vitin 2019'.
U votua me: katërmëdhjetë vota 'për' katër 'kundër' dhe pesë abstenim, gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për vazhdimin e projektit të bashkëfinancimit me KARITAS-in për vitin 2019' dhe mori:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi Nr. 950, i datës 29.10.2018, për lejimin e mjeteve financiare, në shumë të përgjithshme prej 395.000,00€, për vazhdimin e realizimit të projektit 'Ngritja e përkujdesit social dhe shëndetësor në komunën e Fushë-Kosovës', në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me 'CARITAS Kosova' për vitin 2019'.
2. Shuma e mjeteve financiare nga buxheti i komunës, për vazhdimin e realizimit të projektit sipas pikës një (1) të vendimit, lejohet nga kodet e programeve dhe projekteve në kategoritë ekonomike të mallrave e shërbimeve dhe investimeve kapitale për projekte si vijon:
 - 2.1 Nga organizata buxhetore Nr. 612, kategoria ekonomike mallra dhe shërbime Nr. 13460 lejohen për shpenzim mjetet financiare në shumë prej 250,000.00€ në kodet e programeve: shëndetësia Nr. 73150, arsimi Nr. 92010, administrata Nr. 16302 dhe shërbimet publike Nr. 13460;
 - 2.2 Nga organizata buxhetore Nr. 612, programi Nr. 17502, bashkëfinancim i projekteve, Nr. 44684, lejohen për shpenzim mjetet financiare në shumë prej 125,000.00€.
3. Për vazhdimin e realizimit të projektit, sipas pikës një (1) të vendimit, 'CARITAS Kosova', financon me mjete financiare në shumë prej 20,000.00€.

Pika e tetë (8) - Propozim për fillimin e procedurave për themelimin e Teatrit të Qytetit në Fushë-Kosovë.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për fillimin e procedurave për themelimin e Teatrit të Qytetit në Fushë-Kosovë', ftoj Drejtoreshën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që të na jap sqarime.

Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Ne tani e kemi 'Propozimin për fillimin e procedurave për themelimin e teatrit tonë profesional të qytetit', në bazë të 'Ligjit për Teatrot' dhe Rregullores së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për teatrot kombëtare dhe teatrot e qyteteve. Bashkëngjitur në materialin tuaj i keni të zbërthyer kushtet dhe kriteret për themelimin e teatrit. Në Fushë-Kosovë Teatri Amator Qëndresa ka funksionuar për më shumë se tridhjetë vite, që nga viti 1972, i cili ka arritur shumë suksese si teatër amator, tani ne kërkojmë që teatri ynë të shndërrohet në teatër profesional. Duhet të themelohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit një Komision Profesional që verifikon se a plotësohen kushtet për themelimin e teatrit? Ne të gjithë i njohim njerëzit që kanë dhënë kontributin e tyre si: Hazir Haziri

- Dekan në Fakultetin e Arteve, Emin Emini, e shumë të tjerë, vetëm njëri nga këta të tre iniciues, që kanë dalë edhe në media me deklaratat e tyre, ka kaluar në dërrasat e teatrit tonë. Tani kërkojmë vetëm dritën e gjelbër për fillimin e procedurave për teatrin.

Shaban Ademi: Shumë çështje u thanë nga Drejtoresha e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Teatri Qëndresa ka funksionuar para luftës dhe ka pasur suksese. Për shfaqje duhen para, përkrahja pas luftës për teatrin ka munguar, aty ka dhënë shfaqje edhe Fadil Hysaj, por ju jeni fajtor për gjendjen e Shtëpisë së Kulturës sot! Ju po thoni të fuqizohet Teatri Qëndresa, ndërkohë që shumë vendime i shkelni dhe nuk i zbatoni! Ne kemi marrë vendim në Kuvendin e Komunës që të rrënohet objekti i Shtëpisë së Kulturës, i cili është simbol i së keqes dhe racizmit ndaj popullit shqiptar, simbol i dhunës ndaj femrave shqiptare. Ai objekt është i kontaminuar, njëzet vjet pa asnjë investim, është gjynah edhe për punëtorët që punojnë aty, të cilët mund të sëmuren nga ndonjë virus, edhe i kolerës, gjithkund ka myk! Aty nuk ka parakushte për zhvillim të asgjëje, është dashur të zhvillohet një procedurë me partneritet publiko-privat dhe aty të krijohen hapësira të dinjitetshme për kulturën, partitë politike, organizatat joqeveritare, e jo nga ky objekt i mbetur të synojnë të përfitojnë tre persona, aty nuk ka fare kushte për teatër! Nëse duhet të funksionalizohet Teatri Qëndresa, ne jemi që iniciativa të përkrahet, por këtu ka një përzjerje të interesave të individëve të caktuar!

Driton Ademi: Tani e kemi një nismë për fillimin e procedurave për themelimin e teatrit, por kjo iniciativë kërkon që të plotësohen disa kushte dhe kriteret paraprakisht, duhet ta kalojë vlerësimin profesional në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Naser Graiçevci: Çështja e teatrit në Kuvendin e Komunës nuk është trajtuar asnjëherë, për Shtëpinë e Kulturës e kemi një vendim për rrënimin e saj, andaj kushti i parë lidhur me hapësirën nuk plotësohet! Teatri i Fushë-Kosovës ka qenë pjesë e jona, sidomos në vitet e nëntëdhjeta në kohën e okupimit tonë, atëherë ka funksionuar me sukses një ekip i shkëlqyer i aktorëve, që ka mbajtur shfaqje. Shfaqja e fundit e teatrit tonë ka qenë në vitin 2004 'Engjëjt nuk vdesin', teatri e begaton kulturën, tani jemi rrëmbyer vetëm nga seritë turke! Të gjithë i dimë njerëzit e merituar që kanë dhënë kontributin e tyre në teatrin tonë, si: Emin Emini, Hasan Krasniqi, Gani Bajrami, e të tjerë. Unë nuk jam që të rrënohet objekti i Shtëpisë së Kulturës, popujt tjerë i ruajnë edhe vendet si Aushvici, që vizitohen nga shumë njerëz nga mbarë bota, aty duhet të krijohet një vend si muze i gjenocidit serb ndaj shqiptarëve. Nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kërkojmë që të punojë për avancimin e vlerave të kulturës, e jo të individëve të caktuar!

Aida Alimi: Ne në parim jemi për aprovimin e 'Propozimit për fillimin e procedurave për themelimin e teatrit', por kërkojmë që të mos lihen anash aktorët e vjetër që kanë kontribuar në teatrin tonë.

Doruntina Jashari: Ne pajtohemi me propozimin që të ngjallet jeta kulturore dhe kërkojmë që të plotësohen kushtet dhe kriteret për themelimin e teatrit në qytetin tonë.

Remzi Shala: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim 'Propozimin për themelimin e teatrit' duke i plotësuar kushtet dhe kriteret që kërkohen nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, por duke i integruar edhe aktorët e vjetër të Teatrit Qëndresa, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në të kaluarën.

Migjen Kolshi: Për teatrin u diskutua shumë nga parafolësit e mi. Unë e pyes Drejtoreshën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ky propozim a është i juaji apo i Kryetarit të Komunës? Sepse, dikush në komunë u ka premtuar mbështetje këtyre tre personave! Këtu po luhet një lojë politike! Unë jam që teatri të themelohet, por jo nga këta tre persona siç është ai Basha nga Suhareka me deklaratat e tij në media, sepse Suhareka të gjithë e dini, që ka shumë ndikim në komunën tonë! Unë jam i mendimit se kjo pikë duhet të shtyhet, të konsultohen palët dhe t'iu jepet vendi i merituar artistëve tonë. Kështu si e keni propozuar drejtori i teatrit do të jetë personi jashtë komunës sonë!

Nënkryetari i Komunës: Ju para vetes e keni një 'Propozim për fillimin e procedurave për themelimin e teatrit sipas Ligjit për Teatrot', që parasheh plotësimin e disa kushteve dhe kriterëve. Teatri ynë në të kaluarën ka qenë teatër amator, ka pasur suksese, aktorë të mirë, si Emin Emini dhe të tjerë, ne nuk duhet ta ndalim iniciativën, teatrin do ta menaxhojnë njerëzit nga Fushë-Kosova, kemi mjaft aktorë edhe të rinj, si: Shkëlzen Sopjani, Jeton Zogiani.

Migjen Kolshi: Nëse votohet kjo iniciativë është punë e kryer, teatrin e menaxhojnë njerëzit si z. Basha, me konstatimet e të cilit ne nuk pajtohemi!

Nënkryetari i Komunës: Iniciativat nuk duhet të ndalen, ne jemi ekonomi e tregut, nuk jemi vend socialist.

Shaban Ademi: Nëse e miratoni këtë vendim ju së pari duhet ta shfuqizoni 'Vendimin për rrënimin e objektit të Shtëpisë së Kulturës'.

Nënkryetari i Komunës: Për objektin e Shtëpisë së Kulturës, është paraparë të hyjmë në partneritet publiko-privat, këto punë nuk janë të lehta. Iniciativa në fjalë meriton të përkrahet, punëtorët e teatrit do të mbështeten me buxhet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Ali Ismaili: Logjikisht ne jemi dakord për themelimin e teatrit. Në objektin në fjalë nuk kemi kushte, përmirësimi i tyre ka kosto financiare për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Vetëm Komisioni Vlerësues do të jenë profesionistë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Objekti aty është i demoluar, në atë objekt është mbajtur edhe fjalimi famëkeq i Milloshit, është vend ku janë bërë krime, gjenocid. 'Vendimi për rrënimin e objektit të vjetër dhe ndërtimin e objektit të ri' nuk është zbatuar, ne si parti politike nuk kemi hapësira askund, edhe pse këtë punë na e garanton ligji!

Nënkryetari i Komunës: Pagat ndahen nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ne do t'i plotësojmë disa kushte dhe do ta mirëmbajmë objektin.

Ali Ismaili: Sa do të jetë shuma e mjeteve financiare për renovimin e hapësirës aty, dyqind mijë euro apo sa, ne nuk e dimë?

Nënkryetari i Komunës: Ne do të investojmë aq sa ka buxhet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, diku rreth pesëdhjetë mijë euro.

Sabri Rexhepi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Teatri ynë para luftës ka qenë shumë i suksesshëm, ka pasur aktorë të mirë, si: Emin Emini, Fazli Haziri dhe të tjerët. Unë kërkoj që të mos i harrojmë artistët tonë, e jo në krye të jenë virusi dhe persona tjerë.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për fillimin e procedurave për themelimin e Teatrit të Qytetit në Fushë-Kosovë'.

U votua me: katërmëdhjetë vota 'për' asnjë 'kundër' dhe nëntë abstenime, gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për fillimin e procedurave për themelimin e Teatrit të Qytetit në Fushë-Kosovë' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim të Propozimit Nr. 949, të datës 29.10.2018, për fillimin e procedurave për themelimin e Teatrit të Qytetit të Fushë-Kosovës me status publik.

Pika e nëntë (9) - Propozim për ndërrimin e pronës për ndërtimin e shkollës në lagjen e Nakaradës.

Kryesuesja e Kuvendit të komunës: Propozimin për ndërrimin e pronës për ndërtimin e shkollës në Nakaradë do ta shtyjme për një mbledhje tjetër.

Migjen Kolshi: Kjo pikë vjen për të dytën herë në shqyrtim, duhet ta dimë arsyen e shtyrjes! Kërkoj që të hedhet në votim propozimi për miratimin e pikës në fjalë.

Durim Hajra: Raportin e vlerësimit e kemi, pse duhet ta shtyjme këtë pikë!

Driton Ademi: Ne nuk e kemi asnjë arsytim pse kjo pikë duhet të shtyhet!

Nënkryetari i Komunës: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës propozon që kjo pikë të shtyhet për shqyrtim në një mbledhje tjetër, sepse kanë nevojë për sqarime shtesë. Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim që të shtyhet për mbledhjen e ardhshme 'Propozimi për ndërrimin e pronës për ndërtimin e shkollës në lagjen e Nakaradës.

U votua me: trembëdhjetë vota 'për' dhjetë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm, andaj Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, konstatoi se me shumicë të votave 'Propozimin për ndërrimin e pronës për ndërtimin e shkollës në lagjen e Nakaradës', shtyhet për shqyrtim në mbledhjen e ardhshme.

Pika e dhjetë (10) - Propozim për shqyrtimin e kërkesës së Organizatës 'Terre des Hommes' për Qendrën Ditore për mbrojtjen e fëmijëve me qëndrim në rrugë dhe shqyrtimi i rekomandimit nga Komiteti për Politikë e Financa që objekti publik - çerdhja, të ridestinohet për Arkiv të Komunës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim pikën e mbetur nga mbledhja e kaluar për 'Ndarjen e hapësirës dhe objektin e çerdhes së fëmijëve për Organizatën 'Terre des Hommes', për trajtimin e fëmijëve me qëndrim në rrugë dhe rekomandimin e dalë nga mbledhja e Komitetit për Politikë e Financa, që objekti publik - çerdhja e fëmijëve të ridestinohet për Arkiv të Komunës. Hap diskutimin.

Durim Hajra: Tani e kemi 'Propozimin për ndarjen e hapësirës dhe objektin e çerdhes së fëmijëve për organizatën zvicerane 'Terre des Hommes', për trajtimin e fëmijëve me qëndrim në rrugë, që është një propozim shumë i arsyeshëm dhe rekomandimin e Komitetit për Politikë e Financa, që objekti publik - çerdhja e fëmijëve të ridestinohet për Arkiv të Komunës. Meqë në këtë objekt publik nuk mund të ofrohen shërbime për fëmijë siç është çerdhja, ofrimi i këtij projekti për trajtimin e fëmijëve me qëndrim në rrugë është i qëlluar, ku fëmijëve do t'iu sigurohet ushqim dhe ujë, trajtim nga punëtori social, aktivitete psiko-sociale, klasë mësimi dhe ndihmë tjetër të nevojshme. Organizata në fjalë do ta bëjë edhe renovimin e objektit, kjo organizatë është shumë serioze dhe e mirëseardhur që ta kryej këtë punë në komunën tonë. Ne nuk po kemi mundësi t'i

shfrytëzojmë as objektet tjera publike në fshatra, ku në fshatin Bardh i Madh një objekt publik po shfrytëzohet pa asnjë vendim të Kuvendit të Komunës nga një biznes privat. Fakt tjetër është se ky shërbim i ofruar nga kjo organizatë zvicerane që vepron në Kosovë, do të na ndihmojë në trajtimin e fëmijëve rom, ashkalinj dhe egjiptian, pa kosto shtesë financiare për buxhetin e komunës. Unë nuk di ai vend aty nëse është i përshtatshëm për Arkiv të Komunës dhe ai plotëson kushtet e parapara!

Driton Ademi: Në mbledhjen e rregullt për këtë pikë është shterur debati. Është fakt se kjo organizatë merret me çështjet e fëmijëve dhe ndihmon komunitetin dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Kjo punë ndërlikohet edhe me koncept-dokumentet e politikave sociale të Ministrisë që vlejnë edhe për komunën tonë, siç është eliminimi i punëve të rënda për fëmijë, ku Departamenti Amerikan i Shtetit, në takim me përfaqësuesit e Ministrisë dhe Komunave, kërkon që të përkrahen iniciativat për mbrojtjen e fëmijëve. Unë jam për aprovimin e 'Propozimit për dhënien në shfrytëzim të objektit publik - Çerdhes së Fëmijëve për trajtimin ditor të fëmijëve me qëndrim në rrugë'.

Remzi Shala: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim për aprovim rekomandimin nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa që objekti publik - Çerdhja e Fëmijëve të ridestinohet për Arkivin e Komunës. Ne nuk e kontestojmë punën e Organizatës 'Terre des Hommes', por shpresojmë se për ta do të gjendet një zgjidhje tjetër!

Mehdi Lahu: Unë nuk dua t'i përsëris qëndrimet e thëna nga parafolësit e mi, mendimi ynë është se objekti në fjalë duhet të funksionalizohet si Çerdhe e Fëmijëve.

Aida Alimi: Ne jemi që objekti publik - Çerdhja e Fëmijëve të ndahet për Organizatën 'Terre des Hommes', ndërsa rekomandimi i dhënë nga mbledhja e Komitetit për Politikë e Financa është propozim i Kryetarit të Komunës.

Nënkryetari i Komunës: Ky propozim është votuar nga shumica e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Naser Graiçevci: Nuk di çka të them për anëtarët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, por për neve si opozitë, a ka logjikë që Çerdhja e Fëmijëve të ridestinohet në Arkiv të Komunës.

Nënkryetari i Komunës: Objekti gjendet afër Sallës së Sportit, i plotëson kushtet për arkiv, sepse dokumentacionin zyrtar e kemi të shpërndarë, një pjesë është në objektin e Shtëpisë së Kulturës, tani pas kalimit në objektin e ri të komunës kemi nevojë për një objekt modern të Arkivit të Komunës. Ne nuk po e refuzojmë kërkesën e tyre, por nuk kemi mundësi ta japim në shfrytëzim objektin në fjalë. Kryetari i Komunës u ka premtuar atyre në hamendje këtë objekt, pa ndonjë analizë të thellë të çështjes, ne kemi edhe objekte tjera publike në fshatrat: Bardh i Madh dhe Miradi e Poshtme për nevojat e kësaj organizate. Kemi dokumentacion të kadastrit dhe ndërtimeve, të cilin duhet ta sistemojmë në këtë objekt.

Naser Graiçevci: Ne nuk mund ta dimë se ky objekt, pa një analizë të mirëfilltë, sa i plotëson kushtet për vendosjen e dokumentacionit arkivor aty! Ne kërkojmë që, meqë kjo organizatë merret me trajtimin e fëmijëve, t'ia japim mundësinë për shfrytëzimin e këtij objekti publik në qytet.

Ali Ismaili: Në parim ne jemi pro 'Projektit për trajtimin e fëmijëve me qëndrim në rrugë'. Unë nuk i njoh përfaqësuesit e kësaj organizate, mirëpo kjo organizatë financohet nga Qeveria e Zvicrës

dhe meriton të përkrahet, mirëpo tani ne e kemi edhe kërkesën e Ekzekutivit të Komunës, që vë në pah nevojën për sistemimin e dokumentacionit zyrtar, i cili është i shpërndarë dhe mund të dëmtohet, kjo gjendje është e papranueshme! Ne ndajmë rreth katërqind mijë euro për një organizatë tjetër joqeveritare! Unë këtu e shoh se kjo kërkesë është bërë në momentin jo të duhur, edhe pse veprimtaria e tyre është e mirë - trajtimi i fëmijëve. Por për mua më i rëndësishëm është ruajtja e dokumentacionit zyrtar.

Driton Ademi: Nëse nuk i japim në shfrytëzim këtë objekt donacioni për trajtimin e fëmijëve me qëndrim në rrugë humbet.

Durim Hajra: Ne po e humbim një mundësi të mirë, që të sigurojmë trajtimin e fëmijëve me qëndrim në rrugë.

Ali Ismaili: Në Kosovë funksionojnë shumë organizata joqeveritare - mbi tetë mijë, por letrat zyrtare, dokumentacionin, nuk mund ta kemi në një gjendje të keqe dhe në rrezik të asgjësimit të tij. Pajtohem, se kjo çështje është dashur të zgjidhet më herët, sepse këta janë për tetëmbëdhjetë vite në pushtet dhe nuk duhet të kemi situatë të tilla!

Përfaqësuesi i Organizatës 'Terre des Hommes': Përshtendes të pranishmit në mbledhje. Me disa prej jush njihem dhe kemi bashkëpunuar në të kaluarën. Selia e organizatës sonë është në qytetin e Lozanës në Zvicër, aktivitetin e saj në Kosovë e zhvillon që nga viti 1999, me programe të shumta për trajtimin e të miturve. Ne bashkëpunojmë ngushtë me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Qendrat për Punë Sociale në komuna. Formën e bashkëpunimit ne e mbështesim nga një ekspert lokal dhe dy ndërkombëtar. Nëse ky objekt nuk na jepet në shfrytëzim në fund të vitit ne e humbim këtë donacion. Ky trajtim i fëmijëve parashihet edhe me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, që ka kaluar në leximin e parë në Kuvendin e Kosovës. Ne e kemi një buxhet prej një milion euro për tri programe, që merren me çështje sociale dhe trajtimin e fëmijëve, andaj mendoj, se e meritojmë përkrahjen për projektin tonë, që në fakt janë edhe detyra të komunës.

Sabri Rexhepi: Unë nuk pajtohem me asamblistët që këtu luajnë rolin e 'zëdhënës të komunës'! Fëmijët meritojnë të trajtohen, kjo hamendje ndodh vetëm të ne, unë e përkrah për aprovim propozimin në fjalë.

Ali Ismaili: Ju jeni në pushtet për tetëmbëdhjetë vjet dhe nuk e keni rregulluar sistemimin e dokumentacionit zyrtar, unë këtu nuk jam zëdhënës i askujt. Në fillim të diskutimit tim e ceka se nuk i njoh përfaqësuesit e kësaj organizate, në dokumentacion zyrtar ka të dhëna edhe për ndërtime pa leje.

Driton Hasolli: Unë mendoj se nuk është fundi i botës për këtë organizatë nëse ne nuk i japim këtë objekt në shfrytëzim, programet për trajtimin e fëmijëve vazhdojnë. Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Rekomandimin nga mbledhja e Komitetit për Politikë e Financa Nr. 178, të datës 09.10.2018, për ridestinimin e objektit publik - Çerdhes së Fëmijëve me lokacion në oborrin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' në rrugën 'Aziz Zhilivoda', hapësira publike afër Sallës së Sportit, në objekt për Arkivin e Komunës së Fushë-Kosovës për plotësimin e nevojave për sistemimin e dokumentacionit zyrtar të komunës'.

U votua me: dymbëdhjetë vota 'për' nëntë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e një anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi 'Rekomandimin nga mbledhja e Komitetit për Politikë e Financa Nr. 178, të datës 09.10.2018, për ridestinimin e objektit publik - Çerdhes së Fëmijëve me lokacion në oborrin e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' në rrugën 'Aziz Zhilivoda', hapësira publike afër Sallës së Sportit, në objekt për Arkivin e Komunës së Fushë-Kosovës për plotësimin e nevojave për sistemimin e dokumentacionit zyrtar të komunës' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Rekomandimit të Komitetit për Politikë e Financa Nr. 178, të datës 09.10.2018, për ridestinimin e objektit publik - Çerdhes së Fëmijëve në sipërfaqe prej 226 m² me lokacion në oborrin e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' në rrugën 'Aziz Zhilivoda', hapësira publike afër Sallës së Sportit, në objekt për Arkivin e Komunës së Fushë-Kosovës për plotësimin e nevojave për sistemimin e dokumentacionit zyrtar të komunës.


Pika e njëmbëdhjetë (11) - Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Të ndryshme', ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës që ta marrin fjalën, nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në orën 13:40 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha

